

bashkëfshatarë të tjerë u arratisën nga fshati, ndërkaq Bajrami dhe kushëriri Haliti shkuan te një përrorskë e vogël për tu fshehur. Por, shumë shpejt, në atë vend arritën pjesëtarë të forcave serbe. E morën Bajramin dhe Halitin deri te shtëpia e parë e fshatit, e cila ishte afro 500 metra larg vendit ku ata u ndalën. I rrihnin me kondakët. Kur arritën te kjo shtëpi, u urdhëruan Bajramit dhe Haliti që të uleshin dhe, më pas, filluan t'i pyesnin për familjet e tyre dhe UÇK-në. Gjatë përgjigjeve të tij, Bajrami u qetësua përnjëherë dhe nuk përgjigjej më. Haliti e preku lehtë dhe konstatoi se ky kishte dhënë shpirt. Pjesëtarë të forcave serbe e varrosën Bajramin në vendin ku ai ka ndërruar jetë. Katër muaj më vonë, më 28.11.1998, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Bajramit në varrezat e fshatit, ku ai prehet edhe sot.

Burimet: deklarata H.S, FDH-15575; FDH, *Regjistri i personave të zhdukur në periudhën korrik – gusht 1998*, FDH-859.

Muhamet (Beqir) Gashi

(9.01.1945, shqiptar nga Çabiqi/Čabić, komuna e Klinës/Klina, bujk, dhjetë fëmijë)

Forcat serbe e sulmuan fshatin Çabiq/Čabić më 2.08.1998. Familjarët e Muhametit, së bashku me banorë të tjerë, e braktisën fshatin, por ai me armën e vet shkoi drejt pozicioneve të UÇK-së në periferi të fshatit [Çabiq/Čabić]. Ditën tjetër, më 3.08.1998, pjesëtarë të forcave serbe e kanë arrestuar Muhametin. E çuan në stacionin policor të Klinës/Klina. Tre shqiptarë, të cilët ishin të burgosur në stacion në të njëjtën kohë, ishin të fundit që e shihnin Muhametin të gjallë. Nga ajo ditë, atij i humbet çdo gjurmë. Fati i tij nuk është ndriçuar ende. Në listën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është evidentuar në lëndën me numër BLG-804386-01.

Burimet: deklarata B.G, FDH-17956; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Feriz (Tahir) Racaj

(5.10.1928, shqiptar nga Siqeva/Sićevo, komuna e Klinës/Klina, bujk, gjashtë fëmijë)

Në fillim të muajit gusht të vitit 1998,

familja e Ferizit e ka braktisur **Siqevën/Sićevo**. Ferizi me vëllain Selmanin ndenjen në shtëpi për tu kujdesur për vëllain e tretë Galanin, i cili ishte i verbër, si dhe për shoqen e tij Shahen. Në datën **4.08.1998**, pjesëtarë të forcave serbe kanë hyrë në fshat dhe filluan tu vënin zjarrin shtëpive. Kur kanë hyrë në lagjen e Racajve, diku rreth orës 14:00, Ferizi doli nga shtëpia. Nuk i tha askujt se ku po shkonte. Në mbremje, kur pjesëtarë të forcave serbe u tërhoqën nga fshati, djali i Ferizit, Musa, me dy të afërm e kanë gjetur trupin e pajetë të Ferizit afër lumit të Klinës/Klina. Herët në mëngjes, më 5.08.1998, Ferizin e kanë varrosur në vendin ku e kishin gjetur. Pas përfundimit të luftës, më 19.09.1999, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Ferizit në varrezat e Siqevës/Sićevo.

Burimet: deklarata M.R, FDH-15580; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 142, FDH-23857.

Bardhec (Zef) Colaj

(14.05.1946, shqiptar nga Zllakuqani/Zlokućane, komuna e Klinës/Klina, bujk, njëmbëdhjetë fëmijë)

Nikë (Bardhec) Colaj

(5.02.1974, shqiptar nga Zllakuqani/Zlokućane, komuna e Klinës/Klina, bujk)

Në datën **7.08.1998**, djemtë e Bardhecit, Uka dhe Marku, me qerren me kuajt samari bartnin zall në **Zllakuqan/Zlokućane**. Në afërsi të varrezave, ata u ndalën nga një grup burrash të maskuar dhe të armatosur, me një automobil të zi. Ukën e lidhën për një pemë, ndërkaq Markun e liruan të shkonte. Marku shkoi dhe e njoftoi babanë Bardhecin dhe vëllain Nikën. Ata dy shkuan menjëherë te varrezat. Burrat e panjohur e liruan Ukën, ndërkaq Bardhecin dhe Nikën i futën në bagazh të automobil të zi dhe u larguan në drejtim të fshatit Ranoc/Ranovac. Nga ajo ditë, familjarët kanë tentuar që të ndriçojnë fatin e Bardhecit dhe Nikës, por pa sukses. Vetëm pas përfundimit të luftës, në muajin mars të vitit 2005, ata mësuan se mbetjet mortore të Bardhecit dhe Nikës ishin zbuluar në fshatin Leskoc/Leskovac, që në dhjetor të vitit 2003. Familjarët i kanë marrë mbetjet mortore të Bardhecit dhe Nikës